



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 2574

NR. VENDIMI 2259



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
TIRANE

Nr.1296 S.P/2574Regj.Them.

Nr. 2259

Vendimi.

Dt.Regj 05.05.2021 S.P/14.06.2021 Them.

Dt.21.07.2021

Vendimi .

**V E N D I M**

**“Në emer te Republikës”**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga,

**GJYQTARI - BEDRI QORI**

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Katerina Llaka**, sot më datë 21.07.2021, me kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokuror **Ylli Bashaj**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen penale nr. 1296/2574 akti, në ngarkim të ;

**TE PANDEHURIT :** **Besri Kollari**, identifikuar me Kartën e identitetit nr.G30215078T, i biri i Ramazan dhe Hejdije, lindur me 15.02.1963 lindur ne Kruje dhe banues ne Tirane,Rr.”Gjin Bue Shpata”, prane stadiumit Dinamo,Pall.Moskat, shk.4, ap.20, me kombesi dhe shtetesi Shqiptare, me arsim 8 klase, me gjendje familjare i divorcuar, i padenuar, i mbrojtur nga **av. Nertila Qordja** me nr.3638 license, anetar i Dhomes se Avokatise Tirane, zgjedhur me deklarim nga vetë i pandehuri. mbrojtur nga **av.Luljeta Drogu.**, anetar i Dhomes se Avokatise Tiranë, me Nr.4611 License, i caktuar kryesisht nga Gjykata.

**AKUZUAR :**

Për kryerjen e veprave penale “*Prodhimi dhe shitja e lendeve narkotike*” parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal

dhe “Përshtatjae lokalit për përdorim droge ” e parashikuar nga neni 285/a te i Kodit Penal

Në përfundim të hetimit gjyqësor Gjykata, pasi administroi provat shkresore; dëgjo prokurorin, i cili kërkoi:

- Te deklarohet fajtor i pandehuri Besri Kollari, per veprat penale te "Prodhimi dhe e narkotikeve ", qe parashikohet nga neni 283/1 i K. Penal dhe " Pershtatja e lokalit për përdorim droge parashikuar nga nenet 285/a te K.Penal.

Mbrojtësi i të pandehurit Besri Kollari, Av.Nertila Qordja kërkoi: Deklarimin te pafajshem te te pandehurit Besri Kollari per kryerjen e veprave penale te parashikuar nga neni 283/ 1 i K.Penal dhe per vepren penale te parashikuar nga neni 285 / a te Kodit Penal.

Ne alternative, nese gjykata e gjen fajtor te vendosë:

- Deklarimin fajtor te te pandehurit Besri Kollari per kryerjen e veprave penale te parashikuar nga neni 283 / 1 i K.Penal dhe per vepren penale te parashikuar nga neni 285 / a te Kodit Penal, dhe denimin e te pandehurit me 5 (pese } vite burgim.

- Ne aplikim te nenit 406 te K.Pr.Penale, i ulet 1/3 (nje e treta) e denimit dhe perfundimisht i pandehuri Besri Kollari derioher me 3 (tre) vite e 4 (kater) muaj burgim.

- Ne aplikim te nenit 59 te K.Penal urdherohet pezullimi i ekzekutimit te denimit me burgim, duke e vene te pandehurin Besri Kollari ne prove, per nje periudhe kohore prej 3 (tre) vite me kusht qe, gjate kësaj kohe i pandehuri te mos kryeje asnje veper tieter penale si dhe te mbaje kontakte me Sherbimin e Proves.

- Ne aplikim te nenit 60/9 te K.Penal i pandehuri detyrohet qe gjate periudhes se proves te mos shoqerohet me persona te denuar,

I pandehuri Besri Kollari shafaqi pendesë dhe deklaroi se drogën e ka për përdorim vetjak.

si dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi ;

## **V Ë R E N**

Se, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë është sjellë për gjykim çështja penale në ngarkim të të pandehurit **Besri Kollari** akuzuar për kryerjen e veprës penale Prodhimi dhe shitja e lendeve narkotike” parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal dhe “Përshtatjae lokalit për përdorim droge ” e parashikuar nga neni 285/a te i Kodit PenalGjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur per gjykim bazuar në nenin 69 te K.Pr.Penale, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kesaj çështje penale duhet te realizohet perpara kesaj gjykate.

Po keshtu kjo çështje në baze te neneve13 dhe74 të K.Pr.Penale, është në kompetencen lendore te kesaj Gjykate, pasi vepra penale per te cilat janë proceduar të pandehurit gjykohet me trup gjykues te perbere nga nje gjyqtar.

Persa i perket kompetences tokesore, ajo percaktohet shprehimisht në nenin 76 të K.Pr.Penale ku citohet se: “Kompetenca tokesore percaktohet, me rradhe, nga vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale ose vendi ku ka ardhur pasoja”. Persa me siper, perderisa vepra penale dyshohet se është kryer në Tiranë, kompetente per nga territori është kjo gjykate.

Gjithashtu, Gjykata në veshtrim te neneve 13,15,16,17,18 te K.Pr.Penale, çmoi se nuk ekzistojnë shkaqe papajtueshmerie ose perjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pakundershtuar edhe nga palet pasi u prezantua perberja e trupit gjykues.

Në seancën e datës 14.06.2021 mbrojtësi i tij dhe i pandehuri nuk kishin kërkesa për pavlefshmëri apo pa përdorshmëri të provave të sjella nga prokurori. Ne referim te nenit 403 e vijues te K.Pr.Penale i kërkoi gjykates qe te proçedoje me gjykim te shkurtuar pasi çeshtja mund te zgjidhej ne gjendjen qe jane aktet. Kjo kërkesë u depozitua me shkrim gjatë seancës.

Me Ligjin Nr. 41/2021 “**Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar**”, janë bërë ndryshime lidhur me disponimet e gjyqtarit të seancës paraprake. Kështu, me ndryshimet që janë bërë neni 332 i K.Pr.Penale nën titullin “Vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake” parashikohet se: “1. Pasi dëgjon diskutimet e palëve, gjykata vendos: a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq, kur çmon se ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës; b) vijimin e gjykimit nga e njëjta gjykatë kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit; c) të ftojë palët të paraqesin diskutimet përfundimtare kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi. Palët kanë të drejtë të kërkojnë një afat për t’u përgatitur, jo më të gjatë se 15 ditë. Kur i pandehuri akuzohet për kryerjen e një veprë penale për të cilën parashikohet dënim me burgim në maksimum mbi 10 vjet, gjykata cakton datën e seancës dhe njofton kryetarin për të kryer plotësimin e trupit gjykues sipas ligjit; ç) pushimin e akuzës ose të çështjes kur janë rastet e paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kodi; d) deklarimin e moskompetencës dhe dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente në rastet e parashikuara në ligj. 2. Vendimi depozitohet në sekretari brenda 10 ditëve nga shpallja e tij. Palët kanë të drejtë të marrin kopje të tij. 3. Procedura e shqyrtimit në seancë paraprake nuk zëvendëson gjykimin e çështjes në themel dhe as paragjykon vendimin përfundimtar të saj.”.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se nëse paraqitet nga i pandehuri kërkesë për të proceduar me gjykim të shkurtuar dhe plotësohen kushtet ligjore për pranimin e saj, gjyqtari i seancës paraprake nuk merr vendim për dërgimin e çështjes për gjykim por gjyqtari i seancës paraprake shndërohet në gjyqtar themeli dhe ushtron të gjitha kompetencat e tij.

Në këtë rast, gjykata në marrjen e vendimit përfundimtar nuk mbështetet në Kreun “**Përfundimi i Hetimeve**”, ku bën pjesë dhe seanca paraprake, por mbështetet në Kreun “**Vendimi**”, dhe konkretisht në nenet 379 - 399 të K.Pr.Penale, që bën fjalë për marrjen e vendimit nga gjyqtari i themelit. Pra gjyqtari i themelit mund të marrë vetëm tre vendime për akuzën që ka ngritur prokuroria në ngarkim të të pandehurit/ve, të cilat janë: 1) **pushimi i çështjes vetëm në rastet specifike të parashikuara nga neni 387 i K.Pr.Penale**; 2) **vendim pafajësie dhe 3) vendim dënimi**.

Përsa më sipër referuar faktit se nga mbrojtësi i të pandehurit, gjatë seancës paraprake, shfaqën vullnetin për tu proçeduar me gjykim të shkurtuar, gjykata bazuar në nenin 332/c i

kodit të Proçedurës Penale vijon gjykimin e kësaj çështje duke marrë tagrat e gjykatës së themelit.

Në mbështetje të dispozitave të posaçme procedurale ky lloj gjykimi i posaçëm eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to. Në këto kushte fashikulli (dosja) e prokurorit kthehet në fashikull (dosje) gjyqësore duke marrë vlerën e provës pas pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar. Në këtë fashikull bazohen konkluzionet përfundimtare të palëve si dhe gjykata në dhënien e vendimit.

Nga aktet e fashikullit për gjykim të këtij procedimi penal, që merren të mirëqena me vlerën e provës, duke qenë se u procedua me gjykim të shkurtuar, ***rezultojnë faktet e mëposhtme*** :

Më datë 16.01.2021, rreth ores 23 e 50, një grup punonjeshish të policisë, të rukturës policore të Komisarariatit Nr 2 Tirane, në ushtrim të detyrës, kanë shkuar për të verifikuar informacionin e marrë në rrugë operative, sipas të cilit, në lokalitetin e shërbimit bar afe, që ndodhet me emrin "BESI'S", në pronësi të pandehurit Besri Kollari, një grup personash ndodheshin brenda tij, jashtë orarit të përcaktuar si kufi, për qarkullimin e Gërezve, për shkak të kufizimeve të vendosura me akt normativ, në kushtet e pandemisë COVID - 19. Informacioni tregonte gjithashtu se, personat që ndodheshin brenda në lokalitetin, i cili, ishte i regjistruar në regjistrin "tregetar si subjekt" person fizik", në emër të pandehurit, ndodhej në ambientet e pallatit "Moskat", në rrugën "Sulejman Delvina", konsumonin substancë narkotike. Në momentin e verifikimit të informacioneve të marrë, brenda në lokalitetin në fjalë, përveç pronarit të tij, të pandehurit Besri Kollari, janë gjetur edhe shtetasit Aron e Xhezair Kastrati, Izberjan Dalipaj dhe Eljo Mykaj.

Në kontrollin e lokalitetit, në kushtet e flagrancës, brenda, tij u gjetën nëntë qese të boshatisura, që dyshohej se, kishin shërbyer për mbajtje të lëndës narkotike të llojit "kokainë", si dhe disa mjete në forrë pipash të konkretisht gjashtë të tilla, që dyshohej se kishin shërbyer, si mjete për thithjen e substancave narkotike në gjendje pluhuri. Në një enë që shërbente, si mbajtëse e sheqerit, e vendosur në një tavolinë, është gjetur gjithashtu edhe një sasi pluhuri i bardhë, e dyshuar si substancë narkotike. Po ashtu janë gjetur edhe tre kartë plastike me mbetje pluhuri, të ngjashme me produktin e lëndës narkotike në trajtë pluhuri. Ndërsa në një qese tjetër, është gjetur edhe një sasi pluhuri e dyshuar si lëndë narkotike e ngjashme me atë të llojit "Cocaine", peshë e të cilës ishte 0,2 gram. Sendet e sipërshënuara u sekuestruan me cilësinë e provës materiale e të pandehurit Besri Kollari, është shoqëruar në organin e policisë dhe është arrestuar në kushtet e flagrancës, ku ka deklaruar se, **është perdorues i lëndës narkotike** dhe materiali i dyshuar si substancë narkotike është gjetur në vendin e ngjarjes, ka qenë brenda ambientit të banimit të tij.

Nëpermjet të dhenave të pasqyruara në konkluzionet e aktit të ekspertimit kimik me Nr 3068 të datës 02.04.2021, mesohet se i janë nështruar ekspertimit specifik një pjatë porcelani, tre kartë plastike dhe një pjesë qese transparente boshe, sende të gjetura në vendin e ngjarjes e është konkluduar se, tek të gjitha këto sende tregohet prania e kokainës. Po ashtu peshë e pluhurit të mbledhur nga pjatë dhe kartat rezultoi se ishte në masën 0,251 gram.

Nëpermjet të dhenave të pasqyruara në konkluzionet e aktit të ekspertimit kimik me Nr 3075 të datës 02.04.2021, mesohet se i është nështruar ekspertimit specifik një qese transparente plastike, po ashtu e gjetur në vendin e ngjarjes së sipërpermendur dhe peshë e

pluhrit brenda kesaj qeseje vleresuar ne masen eshte 0,285 gram.Pluhuri brenda saj, i cili eshte objekt ekspertimi, tregoi pranine e kokaines.

Ndersa neperrnjete dhenave te pasqyruara ne konkluzionet e aktit te ekspertimit kimik me nr. 2137 te dates 03.03.2021, mesohet se i jane nenshtruar ekspertimit specifik gjashte pipeza plastik edhe keta te gjetur ne vendin e ngjarjes se siperpermendur dhe ne perfundim eshte konkludur se ne siperfaqen e tyre tregohet prania e kokaines.

Te dhenat e pasqyruara ne konkluzionet e aktit te ekspertimit toksikologjiko - ligjor te urines se shtetasit Besri Kollari me Nr 174 date 29.01.2021 tregojne se, ne urinen e tij, u zbulua prania e produkteve te te metabolizmit te Cocaines, ne organizmin e njeriut.Ndersa te dhenat e akteve te ekspertimit toksikologjik te shtetasve Aron e Xhezair Kastrati, Izberjan Dalipaj dhe Eljo Mykaj, tregonin se ne urinen e tyre nuk zbulua prania e produkteve te te metabolizmit te Cocaines, ne organizmin e njeriut.

I pyetur per faktet e mesiperme, i pandehuri Besri Kollari, nuk i pranon ato, po ashtu nuk pranon edhe akuzat e ngritur ndaj tij.

Faktet e cituara me siper te mbeshtetur ne prova, tregojne se ne lokalitetin e shtetasit Besri Kollari, kishte sasi te ndryshme te substanca narkotike te vendosura ne vende te ndryshme e ne procese perdorimi apo mbetjesh te tilla, fakte keto, qe provojne dyshimin, te mbeshtetur si ne prova ashtu edhe ne indicje te rendesishme, te cilat jane te lidhura ngushtesisht mes tyre, se i pandehuri Besri Kollari, ka shperndare mbajtur substanca narkotike, por edhe ka lejuar pershtatjen e lokalitetit, qe administron per grumbullimin e personave, me qellim, qe ata te konsumojne substanca narkotike, duke konsumuar keshtu elementet e veprave penale te siperparuara,

Në diskutimin përfundimtar **organi i akuzës** kerkoi : Te deklarohet fajtor i pandehuri Besri Kollari, per veprat penale te "Prodhimi dhe e narkotikeve ", qe parashikohet nga neni 283/1 i K. Penal dhe " Pershtatja e lokalitetit për përdorim droge parashikuar nga neni 285/a te K.Penal.

**Mbrojtësi** i të pandehurit Besri Kollari, Av.Nertila Qordja kërkoi Deklarimin te pafajshem te te pandehurit Besri Kollari per kryerjen e veprave penale te parashikuar nga neni 283/ 1 i K.Penal dhe per vepren penale te parashikuar nga neni 285 / a te Kodit Penal.Ne alternative, nese gjykata e gjenfajtor te vendose:Deklarimin fajtor te te pandehurit Besri Kollari per kryerjen e veprave penale te parashikuar nga neni 283 / 1 i K.Penal dhe per vepren penale te parashikuar nga neni 285 / a te Kodit Penal, dhe denimin e te pandehurit me 5 (pese) vite burgim.Ne aplikim te nenit 406 te K.Pr.Penale, i ulet 1/3 (nje e treta) e denimit dhe perfundimisht i pandehuri Besri Kollari derioher me 3 (tre) vite e 4 (kater) muaj burgim.Ne aplikim te nenit 59 te K.Penal urdherohet pezullimi i ekzekutimit te denimit me burgim, duke e vene te pandehurin Besri Kollari ne prove, per nje periudhe kohore prej 3 (tre) vite me kusht qe, gjate kesaj kohe i pandehuri te mos kryeje asnje veper tieter penale si dhe te mbaje kontakte me Sherbimin e Proves.Ne aplikim te nenit 60/9 te K.Penal i pandehuri detyrohet qe gjate periudhes se proves te mos shoqerohet me persona te denuar,

**I pandehuri Besri Kollari** shafaqi pendesë dhe deklaroi se drogën e ka për përdorim vetjak.

Faktet e përshkruara më sipër vërtetohen nga: *Procesverbal per kapjen ne flagrance te shtetasit Besri Kollari i dates 17.01.2021. 2.Raport sherbimi i petrpiluar nga punonjesit e policise Edvin Zhupa, Laert Bistri,Edvin Zhuma etj i dates 17.01.2021..Procesverbal pershkrimi e peshimi i proves materiale lendes narkotike dates 18.07.2021.Procesverbale te kqyrjes te vendit te ngjarjes dates 17.01.2021.Procesverbale te kqyrjes i marrjes dhe i sekuestrimit te sendeve prove materiale te dates 17.01.2021.Pocesverbale i sekuestrimit te sendeve prove materiale te dates 17.01.2021 7.Procesverbal per marrjen e urines se shtetasit Besri Kollari i dates 17.01.2021. 8.Procesverbale deklarimi te shtetasve Aron e Xhezair Kastrati, Izberjan Dalipaj dheEljo Mykaj te dates 17.01.2021Procesverbale te deklarimeve te punonjesve te policise Laert Bistri dhe Elvis Isufi.Akt i ekspertimit kimik me Nr 3068 te dates 02.04.2021.Akt i ekspertimit kimik me Nr 3075 te dates 02.04.2021.Akt i ekspertimit kimik me Nr 2137 te dates 03.03.2021.Akt i ekspertimit toksikologjiko - ligjor te urines se shtetasve Besri Kollari me Nr174 date 29.01.2021..Ekstrat historik i regjistrit tregetar te subjektiut "Person fizik ".;Si dhe ne teresi aktet e procedimit penal Nr.380 te vitit 2021*

**I. Në lidhje me veprën penale “Prodhim dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/1 I K.Penal.**

Përgjegjësia penale është detyrimi ligjor i çdokujt, që shkel një rregullim normativ me karakter penal, për t’iu nënshtruar pasojave ligjore me karakter ndëshkues e parandalues. Nisur nga rëndësia që kanë organet proceduese penale përgjatë të gjithë veprimtarisë që përbën në tërësi procedimin penal, nga intensiteti i madh i kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të subjekteve të nënshtruara dhe nga nevoja për zhvillimin e një procedimi të ndershëm, të rregullt dhe tërësisht në përputhje me ligjin, Kodi Penal ka parashikuar disa kushte kumulative që duhet të përmbushen në çdo procedim penal.

Kushtetuta e Republikës sonë në nenin 39 të saj shprehet ndër të tjera se: “Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj”, që njihet me parimin latin “Nullum crimen, nulla poena sine legge”, d.m.th. nuk ka krim, nuk ka ndëshkim pa ligj. Në bazë dhe në zbatim të këtij përcaktimi rezervë ligjore, Kodi Penal fillimisht në nenin 1 dhe më pas në nenin 2 të tij, respektivisht nën titujt “Ligji penal dhe ndarja e veprave penale” dhe “Mosdënimi pa ligj”, shprehet se: “Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat në pjesën e posaçme të këtij Kodi” dhe “Askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër penale që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale. Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj.” Sigurisht, Legjislatori nuk do të mjaftohej kurrsesi me kaq, kështu që, në pjesën e posaçme të Kodit Penal ka parashikuar edhe llojet e veprave penale dhe llojet apo masat përkatëse për to. Përcaktimi i saktë i normës që parashikon veprën penale, ka një rëndësi themelore, sepse është një parakusht për respektimin e parimit të ligjshmërisë, që një person të merret në përgjegjësi penale, e më pas ndaj tij të zbatohet sanksioni penal, sipas figurës së veprës penale saktësisht të kryer prej tij.

Pra, sipas të drejtës sonë penale e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale është që në veprimet ose mosveprimet e tij të ekzistojnë elementët e një figure të caktuar të veprës penale, të parashikuar nga ligji penal. Respektimi dhe plotësimi i elementeve të

figurës së veprës penale ka rëndësi të madhe, sepse ka të bëjë me zbatimin e parimit të ligjshmërisë. Për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj të marra së bashku, të cilët janë: a) objekti i veprës penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive. Provueshmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Nëse nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë ligjorë, personi nuk mund të merret nën përgjegjësi penale dhe rrjedhimisht as të dënohet. Prandaj, në çështjen konkrete, gjykata, duhet të shohë e të verifikojë, ekzistencën e të gjithë elementëve të veprës penale dhe të figurës së saj në veçanti. Figura e veprës penale, pasqyron formën juridike të veprës penale për rastin konkret. Nëse nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë personi, nuk mund të dënohet. Për rrjedhojë, gjyqtari i senancës paraprake në zbatim të nenit 329/b pika 3, të K.Pr.Penale duhet të vendosi pushimin e akuzës ose të çështjes kur janë rastet e paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kodi.

Gjykata përpara se të vendos lidhur me kërkesën e prokurorisë për pushimin e akuzës për figurës e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parshikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, çmon të analizojë elementët e kësaj vepre penale, duke e parë të lidhur me rrethanat e faktit. Kështu, në nenin 283/1 të Kodit Penal parashikohet shprehimisht se: *“Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.”*

Në lidhje me **objektin** e veprës penale, “Prodhimi dhe Shitja e Narkotikëve”. Kështu, objekti i veprës penale “Prodhimi dhe Shitja e Narkotikëve” të parashikuar nga neni 283 paragrafi i parë i Kodit Penal mund të indentifikohet si i dyfishtë në objekt parësor dhe në objekt dytësor. Objekti parësor janë marrëdhëniet juridike që garantojnë shitjen, blerjen, shpërndarjen transportimin, mbajtjen dhe përdorimin sipas dispozitave ligjore përkatëse të lëndëve narkotike e psikotrope, nga veprime të kundra ligjshme e shoqërisht të rrezikshme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e personit, funksionimin normal të veprimtarisë së organeve jetësore të tij. Kjo dispozitë përjashton nga përgjegjësia personale përdoruesit e lëndëve narkotike duke përcaktuar si kritere mbajtjen në doza të vogla, ndërsa përgjigjen penalisht pavarësisht se është përdorim vetjak kur sasia e mbajtur është e madhe. Qëllimi i ligjvënësit në përjashtimin e përdoruesve ka qenë duke i parë ata si viktimat të veprës penale dhe jo si subjekte të kryerjes së saj. Ndërsa objekti dytësor i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga ligji për të garantuar paprekshmërinë e rendit dhe qetësisë publike, jetës dhe shëndetit të njeriut. Kjo tërësi marrëdhëniesh juridike dhe jo vetëm janë të mirat publike dhe të të mbarë shoqërisë që justifikojnë dhe përligjin ekzistencën e legjislacionit penal.

Në lidhje me **anën objektive** të figurës së veprës penale “Prodhimi dhe Shitja e Narkotikëve”. Gjykata thekson se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idetë e tij. Pra, ana objektive paraqet sulmin kriminal të shqyrtuar

nga ana e tij e jashtme, nga pikëpamja e zhvillimit gradual dhe konsekuent të ngjarjeve dhe fenomeneve, të cilat fillojnë të vihen në lëvizje me kryerjen nga subjekti i veprimit ose mosveprimit dhe përfundojnë me ardhjen e një rezultati të caktuar kriminal. Nga teoria e së drejtës penale dhe praktika gjyqësore rezulton se, element të anës objektive të figurës së veprës penale janë: i) veprimi ose mosveprimi i kundërligjshëm; ii) mënyra e kryerjes së veprës penale, me të cilën kuptohet renditja e veprave, metodat e përdorura, karakteri kronologjik dhe specifika e lëvizjeve që bën personi për kryerjen e veprës penale. Mënyra e kryerjes së veprës penale lidhet ngushtësisht me mjetet e përdorura nga personi për realizimin e saj; dhe iii) Koha, vendi dhe ambjenti i kryerjes së veprës penale, me të cilën kuptohet grumbullimi dhe unitetit i kushteve konkrete, në të cilat kryhet veprimi ose mosveprimi kriminal, në të cilat zhvillohet lidhja shkakësore dhe vjenë rezultati (pasoja) kriminale. Këto kushte ekzistojnë objektivisht dhe pavarësisht nga vullneti i subjektit i veprës penale.

Kështu, për të patur konsumimin e veprës penale “Prodhimi dhe Shitja e Narkotikëve” parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal parimisht duhet që i pandehuri, subjekti aktiv i saj, të kryejë njërën prej veprimeve aktive që dispozita e mësipërme liston në mënyrë kufizuese dhe të mbyllur. Këto s’janë gjë tjetër veçse figurat konkrete të veprës penale mëmë që është “Prodhimi dhe Shitja e Narkotikëve”. Për shembull, ai duhet t’u shesë atë. Shitja, në rastin konkret, është dhënia e lëndës narkotike, të substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo i farërave të bimëve narkotike një tjetri kundrejt çmimit, të çfarëdo sasive qoftë por e kufizuar kjo në një veprim konkret apo e shumta në disa veprime pa një lidhje të qëndrueshme, pa një mendim unik e vazhdues kriminal, e me frekuenca jo të rregullta të ndodhjes së saj. Për qëllime të ligjit do të mjaftonte një transaksion i tillë për ta quajtur të konsumuar këtë figurë të veprës penale. Shitja si koncept juridik edhe mund të huazohet nga e drejta civile, për t’u kuptuar si natyrë veprimi juridik në këtë rast, por nuk do të mund të shkonte logjika referuese më tej, pasi, sigurisht, që në rastin konkret flasim për një veprim absolutisht të pavlefshëm, pasi sendi i kontraktuar ndalohet të qarkullojë civilisht dhe si i tillë veprimi juridik ndalohet nga ligji.

Një variant tjetër i konsumimit të kësaj vepre penale është ofrimi për shitje. Ofrimi për shitje është shfaqja e vullnetit në mënyrë të padyshimtë të poseduesit të lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike diku për ta shitur atë. Kjo figurë vepre penale dhe kjo shfaqje e vullnetit mund të ndodhë me çdo veprim të mundshëm komunikimi, qoftë edhe me veprime konkludente. Vetëm shfaqja e vullnetit të poseduesit të lëndës ligjërisht të ndaluar do të jetë e nevojshme dhe e domosdoshme për të patur këtë figurë vepre penale. Dhënia ose marrja në çdo formë si figurë konkrete e veprës penale mëmë synon të përfshijë të gjitha llojet e veprimeve që kalojnë posedimin e lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike, të pa përfshira në dispozitë, p.sh. shkëmbimi, dhurimi etj. Edhe në këtë rast do të jemi në të njëjtën logjikë juridike të rasteve të mësipërme, që do të thotë se veprimi kriminal konkret ndodh një herë apo edhe disa herë por pa u bërë qëllim në vetvete dhe mjaftueshëm i shkëputur në kohë sa për të mos u ravijëzuar si veprimtari e vazhdueshme apo e qëndrueshme kriminale.

Transportimi si një prej figurave konkrete konsumohet duke u realizuar zhvendosja e lëndës narkotike nga një vend në një vend tjetër pa qenë nevoja për veprime të tjera. Dërgimi është figurë mjaft e ngjashme me transportimin e lëndës narkotike veçse karakterizohet nga një instensitet më i ulët fizik i zhvendosjes së saj. Dërgimi është një formë e ndërmjetme midis transportimit dhe dorëzimit si figura të veçanta kriminale. Dorëzimi është veprimi fizik i lënies



së lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike në destinacionin e porositur. Mbajtja si figurë konkrete kriminale është posedimi i qëndrueshëm dhe latent i lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike nga një subjekt në vende të caktuara për këtë qëllim, me qëllim për ta ofruar, shpërndarë, transportuar, dorëzuar, dërguar, tregtuar apo për ta dhënë në çdo formë kundrejt një subjekti tjetër. Megjithëse qëllimi nuk është i shprehur në dispozitë, Gjykata çmon se vetëm në të tillë mënyrë interpretimi kjo figurë konkrete e veprës penale shfaq veprimtari që karakterizohet nga rrezikshmëria shoqërore.

Megjithatë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë pranuar se kjo figurë vepre penale mund të quhet e konsumuar edhe pa u vërtetuar qëllimi si element i anës subjektive. Të katërta këto figura të mësipërme kanë një gjë të përbashkët, faktin se këto forma objektive kriminale janë një pjesë e aktivitetit kriminal të trafikimit apo tregtimit të lëndës narkotike, janë hallka të ndërmjetme të një veprimtarie kriminale tërësore. Në këto kushte, pavarësisht aftësisë zbuluese dhe proceduese të organeve të ndjekjes penale të shtetit, këto vepra penale gjithmonë kryhen në bashkëpunim, pasi janë pjesë e një veprimtarie të tërë. Për të vazhduar më tej me figurat konkrete, njëra prej tyre është shpërndarja. Shpërndarja është tërësia e veprimeve fizike transportuese, dërguese, dorëzuese apo dhënie në çdo formë, në mënyrë të përsëritur të lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike në një apo disa pika të ndryshme. Ajo presupozon një shtrirje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme në kohë të veprimeve të përmendura më sipër dhe për këtë arsye përbën krim latent apo vazhdues, pasi ndodh në boshtin e të njëjtit mendim unik kriminal.

Tregtimi i lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike, si figurë konkrete e veprës penale presupozon krijimin e një veprimtarie tregtare të subjektit aktiv të veprës penale me këto lëndë. Kryerja e shitjeve, shkëmbimeve apo e çdo veprimi tjetër me karakter tregtar, apo e çdo lloj transaksioni të mundshëm që sjell përfitime pasurore dhe që synon të kalojë posedimin e lëndës së ndaluar ligjërisht, e shtrirë në kohë në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme nën një mendim unik kriminal do të përbente figurën e veprës penale të posaçme të tregtimit. Natyra e dy figurave të veprës penale të sqaruara së fundmi është e përbashkët dhe njëkohësisht dallon nga figurat e renditura jo paqëllim më sipër për nga karakteri sporadik i ndodhjes dhe i lidhjes midis tyre. Dy figurat e fundit të veprës penale sigurisht që paraqesin rrezikshmëri shoqërore më të lartë se sa të parat për të gjitha arsyet e sqaruara më sipër.

Por kërkesat e ligjit, për t'i kualifikuar këto veprime objektive si kriminale dhe si figura të veçanta të veprës penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, nuk ndalojnë këtu. Dispozita 283 paragrafi parë është një dispozitë blankete apo e bardhë dhe si e tillë për t'u bërë e zbatueshme kërkon domosdo ekzistencën e një ligji tjetër të cilës do t'i referohet rast pas rasti. Kështu, dispozita shprehet "... në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre ...". Kjo do të thotë se veprimet e mësipërme aktive të subjektit aktiv të veprës penale duhet të jetë në kundërshtim me parashikimet e ligjit që rregullon regjimin juridik të lëndëve narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike, konkretisht të Ligjit Nr. 7975 të datës 26.07.1995 "*Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope*", i ndryshuar. Në këtë mënyrë plotësohet hipoteza e përgjithshme e ekzistencës së veprës penale dhe parashikimit të saj nga ligji (premissa maior).

Gjykata çmon të theksojë se, krimi i prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike që

parashikohet në nenin 283 të Kodit Penal, përveç shitjes, ofrimit për shitje, marrjes në çdo formë, shpërndarjes, tregtimit, transportimit, dërgimit dhe dorëzimit të substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, nga ana objektive, kryhet edhe në formën e mbajtjes së këtyre lëndëve, substancave e farërave, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre. Lidhur me këtë formë (mbajtjen) të anës objektive të kësaj figure krimi, Ligjvënësi, si kriter përcaktues për ekzistencën e vetë figurës së krimit dhe, për pasojë, të bazës së përgjegjësisë penale për personat që e konsumojnë atë, ka parashikuar dy rrethana specifike: së pari, mbajtjen e substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe të farëve të bimëve narkotike jo për përdorim vetiak dhe së dyti, edhe kur rezulton i provuar fakti që, këto lëndë mbahen nga personi për përdorim vetiak, në aspektin sasior, ato nuk duhet të jenë në doza të vogla.

Përsa i përket rrethanës së parë, Gjykata vë në dukje se ajo është rrethanë fakti - rezultat i procesit të të provuarit nëpërmjet analizës, në zbatim të kërkesave të dispozitës së nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, të provave dhe indicieve, në të cilat duhet të bazohet gjykata për të arritur në përfundime të drejta, nëse lënda narkotike dhe psikotrope, etj, mbahet nga personi për përdorim vetjak apo për të kryer në vijim, ndonjërin apo disa nga veprimet e tjera të përmendura në dispozitë, që janë elementë të anës objektive të figurës së krimit të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve. Theksojmë se, e veçanta e rrethanës “**përdorimi vetjak**” është se ajo nuk qëndron më vete. Ajo nuk mund të shërbejë e vetme për të arritur në përfundimin se, duke u bazuar vetëm në ekzistencën e saj nuk ekziston edhe figura e krimit të parashikuar në nenin 283 të Kodit Penal. Kësisoj, ajo nuk mund të shërbejë e vetme për të arritur në përfundimin se nuk ekziston baza ligjore (figura e krimit) për të marrë mbajtësin e tyre në përgjegjësi penale. Përkundrazi, për të mos u marrë mbajtësi i lëndëve të tilla në përgjegjësi penale duhet të provohet se ekziston edhe rrethana e dytë, që ka lidhje me sasinë e këtyre lëndëve, e cila, sikurse shprehet ligjvënësi në vetë dispozitën e përmendur, duhet të jetë “në doza të vogla”.

Nocioni juridiko-penal që është shprehur nga ligjvënësi me togfjalëshin “në doza të vogla”, edhe pse nuk mund të bëhet ndonjë përcaktim numerik i sasisë së lëndëve të ndaluara që do të shprehte në peshë sasinë e dozës për t’u konsideruar e vogël, duhet të interpretohet në kuptimin që, në aspektin sasior, lënda narkotike dhe psikotrope, etj., duhet të jetë në atë masë sa të konsiderohet realisht e vogël për përdorim vetjak nga ana e individit konkret dhe jo në përgjithësi. Ajo nuk duhet të tejkalojë aftësitë fiziko-biologjike të individit përdorues dhe brenda kufijve të tolerancës që paraqet organizmi i tij për llojin konkret të lëndës narkotike, në momentin dhe kushtet e përdorimit të kësaj lënde, për të mos krijuar tek ai efekte tej asaj shkalle që do t’i dëmtonin shëndetin. Kështu, doza e vogël, në kuptimin ligjor të saj, konsiderohet jo ndarja fizike në disa të tilla, por sasia e lëndës apo substancës narkotike e psikotrope që ajo përmban si e tërë dhe që sipas ekspertëve vlerësohet si dozë e vogël.

Gjykata çmon se, përcaktim i tillë i nocionit “në doza të vogla”, për efekte të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të Kodit Penal, veç rolit parandalues që luan për ruajtjen e shëndetit të përdoruesve dhe personave që kanë vartësi nga droga, luan dhe rolin e parandalimit të përgjithshëm në luftës kundër fenomenit të përdorimit të kundraligjshëm të këtyre lëndëve, i cili ku gjen përhapje në përmasa të mëdha, shndërrohet në patologji sociale. Në kushtet kur tek ne ende nuk janë përcaktuar, me ligj të posaçëm apo me akte nënligjore, rastet e përdorimit të lëndëve narkotike dhe psikotrope “në përputhje me ligjin dhe jo në kapërcim të

tyre”, përcaktimi si më sipër i nocionit juridiko-penal “në doza të vogla” shërben edhe për ngushtimin, në një masë të arsyeshme, të hapësirave, shfrytëzimi i të cilave, në forma të padrejta, nga keqbërësit, do të ndikonte në shmangien pa të drejtë nga përgjegjësia penale të përdoruesve të lëndëve narkotike dhe psikotrope, të cilët shpesh konstatohet se janë edhe shpërndarës të këtyre lëndëve.

Për të përcaktuar nocionin “dozë e vogël”, Gjykata mban parasysh dhe jurisprudencën e Gjyktës së Lartë në vazhdimësi. Kështu në vendimin Nr. 138, datë 16.11.2017 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ndër të tjera thuhet se: .....Gjykata Kushtetuese kur ka rrëzuar kërkesën për shfuqizimin si antikushtetues të togfjalëshit “dhe në doza të vogla” të nenit 283/1 të Kodit Penal, në vendimin e saj nr. 55/2015, datë 21.07.2015, ka vërejtur se: Gjykata vëren se në lidhje me sasinë që do të konsiderohet si “e vogël”, Gjykata e Lartë nuk ka përcaktuar ndonjë kriter apo kufizim, por ka vlerësuar se kjo bëhet rast pas rasti. ***Ndaj çdo gjykatë, gjatë shqyrtimit të çështjeve konkrete, nuk ka asnjë pengesë që rast pas rasti të vlerësojë nëse sasia që i është gjetur të pandehurit përmbush kërkesën e nenit 283/1 të KP-së. (Vendimi nr. 55/2015, datë 21.07.2015, i Gjykatës Kushtetuese).***

Meqenëse në rastet e përdorimit vetjak dhe në doza të vogla procedimi penal nuk duhet dhe nuk mund të vazhdojë, pasi rasti për përdorim personal, në doza të vogla, nuk përbën vepër penale, duke përjashtuar nga ndjekja penale personat që mbajnë lëndë narkotike për përdorim vetjak dhe në doza të vogla. Me synimin për të interpretuar dispozitën objekt shqyrtimi në përputhje me parimin e ligjshmërisë, të përcaktueshmërisë, të atij të sigurisë juridike, si dhe për të krijuar bindjen se cilat janë sasinë e lëndës narkotike që do të përbënin “doza të vogla”, referencë do të bëhet edhe në drejtën e krahasuar nga ana e këtij Kolegji. Kjo referencë, për disa nga llojet e lëndëve narkotike, do të bëhet për faktin se rezultatet e shkencës mjekësore, mund të bëhen të pranueshme edhe përtej kufijve shtetërore.

Kështu, në të drejtën italiane, për lëndën narkotike të llojit heroinë: Doza mesatare ditore e parimit aktiv është 25 mg, frekuenca ditore si kriter i vendosur në varësi të llojit të lëndës narkotike dhe ndryshimeve psiko-fizike, në maksimum është 10 herë në ditë, ndërsa Doza Maksimale e lejueshme ditore është 250 mg, me një përqendrim 1,7 (15%); për lëndën narkotike të llojit kokainë: Doza mesatare ditore e parimit aktiv është 150 mg, frekuenca ditore si kriter i vendosur në varësi të llojit të lëndës narkotike dhe ndryshimeve psiko-fizike në maksimum është 5 herë në ditë, ndërsa Doza Maksimale e lejueshme ditore është 750 mg, me një përqendrim 1,6 (55%); për lëndën narkotike të llojit cannabis sattiva: Doza mesatare ditore e parimit aktiv është 25 mg, frekuenca ditore si kriter i vendosur në varësi të llojit të lëndës narkotike dhe ndryshimeve psiko-fizike në maksimum është 15 herë në ditë, ndërsa Doza Maksimale e lejueshme ditore është 500 mg, me një përqendrim 5 (10 %). Në të drejtën austriake, doza maksimale për përdorim personal për lëndën narkotike të llojit heroinë është 500 mg, ***për lëndën narkotike të llojit kokainë është 1500 mg***; për lëndën narkotike të llojit cannabis është 2000 mg.

Në rastin konkret të pandehurit Besri Kollari i është gjetur në ambientet e banimit , e cila ishte e përshatur edhe si lokal një dozë me sasi 0.285 gram. Nga akti i ekspertimit kimik nr.3075 datë 02.04.202i rezulton se: Pluhuri brënda saj , i cili është object ekspertimi tregoi praninë e kokainës. Cka do të thotë se jo e gjithë sasia prej 0.285 gram i përket llojit të lëndës narkotike kokainë por ka përmbatje kokaine.

Gjykata vlerëson se në mungesë të një arsytimi ndryshe nga ana e prokurorit, ka

rezultuar se nisur nga sasia e relativisht e vogël të rëndës narkotike, nisur nga fakti se sipas arsytimit të gjykatave kemi një dozë “të vetme”, nisur nga mungesa e rrethanave të tilla që nuk janë përmendur në arsyetimin e tij, që të çojnë në përfundimin se qëllimi i pandehurit ka qenë shpërndarja e drogës tek të tretët, vlerësohet se sasinë e lëndës narkotike i gjykuarit, e ka mbajtur për përdorim vetjak ndaj nuk është respektuar drejt neni 283 i Kodit Penal. Kjo për faktin se nga se nga aktet e prokurorit nuk ekziston ndonjë provë në ngarkim të të pandehurit që të vërtetojë, tej çdo dyshimi, se e ai e ka mbajtur dozën e lëndës narkotike për qëllim, tregtimi apo shpërndarje të çdo forme të parashikuar nga ana e dispozitës së parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal. Në këto kushte, ekzistenca e faktit penal mbetet e dyshimtë dhe ky dyshim nuk ka kaluar pragun e dyshimit të arsyeshëm të mbështetur mbi prova.

Prokurori nuk ka arsyetuar dhe aq më tepër nuk kanë argumentuar në lidhje me praninë e qëllimit të ndryshëm nga ai i përdorimit personal të lëndës narkotike të sekuestruar ndaj të pandehurit, duke mos bërë dallimin e nevojshëm për konfigurimin e veprimeve të tregtimit, shpërndarjes në çdo forme të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal. Në rastin konkret, prokuroria nuk ka arritur të shpjegojë se si dhe pse një sasi lënde narkotike relativisht e vogël, dozë e vetme, do të ishte destinuar për një qëllim shpërndarjeje në banesën e përshtatur për lokal nga ana e të pandehurit.

Te dhenat e pasqyruara në konkluzionet e aktit të ekspertimit toksikologjiko - ligjor të urines se shtetasit Besri Kollari me Nr 174 date 29.01.2021 tregojnë se, në urinen e tij, **u zbulua prania e produkteve të metabolizimit të Cocaines**, në organizmin e njeriut.

Ndërsa te dhenat e akteve të ekspertimit toksikologjik të shtetasve Aron e Xhezair Kastrati, Izberjan Dalipaj dhe Eljo Mykaj, tregojnë se në urinen e tyre nuk zbulua prania e produkteve të metabolizimit të Cocaines, në organizmin e njeriut. Pra nuk vërtetohet fakti ,tey cdo dyshimi të arsyeshëm se lenda narkotike e llojit kokaine ishte për shitje apo shpërndarje pasi nga të dhënat e akteve toksikologjike të klientëve të lokalit rezultoi që nuk ishin përdorues të lëndës narkotike.

Pra përse më sipër gjykata çmon se akuza e ngritur ndaj të pandehurit Besri Kollari për veprën “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, është e pabazuar në prova dhe si e tillë duhet të pushohet.

## ***II. Në lidhje me veprën penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge ” e parashikuar nga neni 285/a të i Kodit Penal.***

Neni 285/a I K.Penal parashikon: *Përshtatja ose lejimi për përshtatjen e lokalit, banesës, mjeteve motorike dhe të çdo mjeti tjetër publik ose privat për grumbullimin e personave me qëllim që ata të konsumojnë substanca narkotike ose psikotrope, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.*

Në lidhje me **objektin** e veprës penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, Gjykata thekson se objekt i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të parandaluar dhe luftuar përhapjen e përdorimit të lëndëve narkotike, kundër atyre individëve të cilët e mbështesin këtë veprimtari të paligjshme duke përshtatur dhe lejuar pasurinë private për grumbullimin e personave me qëllim që ata të konsumojnë substanca të palejueshme nga ligji. Në lidhje me **anën objektive** të figurës së veprës penale të “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, Gjykata thekson se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka veprë

penale. Askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idetë e tij. Vepra penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, kryhet me veprime ose mosveprime të kundërligjshme, që konsistojnë në “përshtatjen” ose “lejimin” e lokalit apo çdo ambjenti tjetër privat për grumbullimin e personave me qëllim që ata të konsumojnë substanca narkotike ose psikotrope.

Në rastin konkret gjatë kontrollit e lokalit, ne kushtet e flagrances, brenda, tij u gjeten nente qese te boshatisura, qe dyshohej se, kishin sherbyer per mbajtje te lendes narkotike te llojit " kokaine ", si dhe disa mjete ne forme pipash e konkretisht gjashte te tille, qe dyshohej se kishin sherbyer, si mjete per thithjen e substancave narkotike ne gjendje pluhuri. Ne nje ene qe sherbente, si mbajtese e sheqerit, e vendosur ne nje tavoline, eshte gjetur gjithashtu edhe nje sasi pluhuri i bardhe, e dyshuar si substance narkotike. Po ashtu jane gjetur edhe tre karta plastike me mbetje pluhuri, te ngjashem me produktin e lendes narkotike ne trajte pluhuri. Janë kryet aktet e eksertimit për këto sende dhe të te gjitha është gjetur prania e lëndës narkotike e llojit kokainë. Në këto kushte, Gjykata çmon se, në çështjen objekt gjykimi, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se nga ana e të pandehurit Besri Kollari janë plotësuar elementët e anës objektive të veprës penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, parashikuar nga neni 285/a i Kodit Penal.

Në lidhje me **anën subjektive** të figurës së veprës penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, për të qenë përpara kësaj vepre penale, duhet që i pandehuri të veprojë me dashje. Në rastin konkret i pandehuri ka vepruar me dashje duke ju vënë në dispozicion lokalit dhe duke ju krijuar lehtësira shtetasve të mësipërm për përdorimin e lëndës narkotike të llojit kokainë. Gjithashtu, gjykata vlerëson se, ana subjektive e figurës së veprës penale zbulohet dhe qartësohet nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme psikike dhe psikologjike jo vetëm që ngacmohen nga faktorë të jashtëm, por edhe materializohen në veprimtarin kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objective Në rastin konkret nga sendët e sekuastruara , 6 pipa dhe tre karta që shërbenin për ndarjen e lëndës narkotike, në lokalit e të pandehurit rezulton e provuar se i pandehuri ju krijonte lehtësira edhe klientëve të tij për përdorimin e lëndës narkotike.

Në lidhje me **me subjektin e veprës** penale. Në rastin konkret, i pandehuri në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë mbi 14 vjeç, dhe rrjedhimisht Gjykata, në vështrim të nenit 12/1 të Kodit Penal, çmon se në drejtim të moshës i pandehuri Besri Kollari, ka qenë madhor e i përgjegjshëm penalisht në datën e kryerjes së veprës penale objekt gjykimi dhe, si e tillë, ai ka patur moshën për përgjegjësi penale. Gjithashtu, në çështjen objekt gjykimi nuk u provua që i pandehuri të vuajë ngandonjë turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale. Përkundrazi me veprimet e tij provohet që ai ka qenë i aftë të posedojë aftësi intelektuale dhe vultive për të kuptuar dhe vlerësuar sjelljen e tij dhe ta kontrollojë atë. Në këto kushte, gjykata vlerëson se i pandehuri është subjekt i përgjegjshëm penalisht.

Në referim të analizës së mësipërme, rezulton se janë konsumuar të gjithë elementët e figurës së veprës penale të “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, parashikuar nga neni 285/a i Kodit Penal, e për pasojë gjykata vlerëson se i pandehuri Besri Kollari duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e saj.

*Persa i perket llojit dhe mases se denimit.*

Dënimi penal është formë juridike e shtrëngimit shtetëror, i lindur dhe i destinuar për ndëshkimin dhe parandalimin e veprave penale. Dënimi penal ekziston dhe zbatohet nëpërmjet ligjshmërisë. Parimi i ligjshmërisë së dënimit nënkupton dënimin e autorëve të veprave penale vetëm me ligj dhe caktimin e tij në përputhje të plotë me ligjin penal. Me respektimin e këtij parimi të drejtat dhe liritë e njeriut, paprekshmëria e tij, duke synuar që asnjë fajtor të mos i shmanget përgjegjësisë për veprën penale të kryer dhe asnjë shtetas të mos dënohet padrejtësisht.

Parimet bazë që udhëheqin caktimin e dënimit nga gjykata parashikohen para së gjithash nga neni 1/c të Kodit Penal i cili parashikon se *“Kodi penal bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit”*.

Qëllimi i dënimit penal është:

- *Të ndëshkojë autorin e veprës penale, që deklarohet fajtor për kryerjen e saj.*
- *Të ndalojë fajtorin nga kryerja e veprave penale të tjera në të ardhmen.*
- *Të ndikojë në riedukimin dhe rehabilitimin e të dënuarit.*
- *Të ndikojë në edukimin e shtetasve të tjerë, sidomos tek ata me predispozita për t'u futur ose tërhequr në veprimtari kriminale, me ndjenjën e respektimit të ligjit që të mos kryejnë vepra penale.*

Shkenca e së drejtës penale për qëllimin e dënimit shprehet se termi *parandalim i posaçëm*, përfshin tre objektivat e para të tij dhe *parandalimi i përgjithshëm*, i cilin nënkupton efektet dhe ndikimin e dënimit tek personat e tjerë që të mos kryejnë vepra penale.

Gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit i referohet nenit 47 të Kodit Penal i titulluar *“Mënyra e caktimit të dënimit”* i cili parashikon se *“Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese”*.

Individualizimi i dënimit është një parim specifik i institutit të dënimit, që lidhet drejtpërdrejtë si me llojet dhe masat e dënimit të mundshëm të parashikuar nga ligjvënësi, ashtu edhe me dënimin konkret që caktohet nga gjykata ndaj autorit të veprës penale. Ligjvënësi në parashikimin e marzhit të dënimit për një vepër penale mban në konsideratë rrezikshmërinë shoqërore të saj, kurse gjykata mban parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer realisht, të autorit të saj dhe të fajësisë së tij si dhe rrethanat e tjera të çështjes, zbatimi i të cilave ndikon në individualizimin e dënimit.

Thelbi i parimit të individualizimit të dënimit është dënimi i përshtatshëm. I përshtatshëm është ai dënim që jepet në bazë të kriterëve dhe kërkesave ligjore, që pengon kryerjen e mëtejshme të veprimtarisë kriminale të autorit të veprës penale dhe ndikon pozitivisht në edukimin e tij e të opinionit shoqëror.

Gjykata në përcaktimin e shkallës së fajësisë, mban parasysh se vepra penale *është kryer me dashje të direkte*.

Parimi i individualizimit përmban në thelb **parimin e proporcionalitetit** mes veprës penale të mbetur në tentativë dhe dënimit që caktohet ndaj autoreve të saj. *“Gjykata, duke pasur parasysh dhe doktrinën e konsoliduar evropiane në këtë fushë, konstaton se, që të*

*jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën. Në këtë mënyrë, që të mund të ketë një proces riedukativ të suksesshëm, duhet që ndëshkimi penal të perceptohet nga autori i veprës si i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën e kryer. ....” (Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 01.06.2011).*

Për sa i përket llojit dhe masës së dënimit, që duhet të vuajë i pandehuri Gjykata çmon se, duhen mbajtur parasysh këto rrethana :

- Rrezikshmërinë relativisht të ulët të veprës penale të “*Përshtjajta e lokalit për përdorim droge*”, për të cilën ligjvënësi, në kohën e kryerjes së saj, kishte parashikuar një dënim deri në pesëvjet burgim.

- Faktin se i pandehuri nuk është i dënuar më parë .

- Faktin se, i pandehuri nuk i është shmangur hetimit dhe gjykimit

- Faktin se i pandehuri është i divorcuar;

- Faktin se i pandehuri është i vetmi që punon për të siguruar të ardhura për familjarët e tij;

- Faktin se i pandehuri është hetuar dhe gjykuar me masen e sigurimit personal “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqesore*” dhe nuk i është shmangur hetimit;

Nisur nga sa më sipër gjykata vëren se, rrethanat e mësipërme në kompleksitet janë lehtësuese për të pandehurin. Për rrjedhojë Gjykata çmon se, i pandehuri **Besri Kollari**, duhet të dënohet *me 1 (një) vit burgim*. Për shkak se, ndaj të pandehurit u zhvillua gjykimi i shkurtuar, bazuar në nenin 406 të K.Pr.Penale, masa e dënimit ulet me 1/3 (një të tretën) e tij dhe përfundimisht i pandehuri **Besri Kollari**, dënohet *me 8 muaj muaj burgim*.

Nisur nga rrezikshmëria e paketë e veprës penale, fakti që është kryefamiljar dhe me detyrime thelbësore ndaj të tretëve, si dhe fakti që ai nuk paraqet rrezikshmeri shoqerore, Gjykata çmon se duhet të aplikohet neni 59 i K.Penal, (*i ndryshuar me ligjin Nr. 35 te Vitit 2017*). Urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim duke e vënë të pandehurin në prove për një periudhë prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajsh me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale si dhe të mbajë kontakt me Shërbimin e Provës. Në aplikim të nenit 60/9 të K.Penal i pandehuri detyrohet që gjatë periudhës së provës të mos shoqërohet me persona të dënuar. Afati i proves fillon nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

Gjykata vlerëson të theksojë se qëllimi i zbatimit të dënimeve alternative është të reduktojë dëmin e ardhur nga vepra penale dhe të reduktojë përfshirjen e individit në sistemin e drejtësisë penale, duke i shërbyer sa më mirë asaj që quhet drejtësia restauruese, e cila në thelb nënkupton vendosjen e një ekuilibri ndërmjet interesave të shoqërisë për t’u mbrojtur nga kriminaliteti si dhe interesave të autorit të veprës penale që është në konflikt me ligjin. Zbatimi i alternativave të dënimit me burgim, lidhet në mënyrë të pazgjidhshme me ekzistencën e vetë dënimit si dhe me parashikimin në ligj të tyre.

Në lidhje me aplikimin e dënimit alternativ të “***Pezullimit e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë***” të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal i cili përcakton se: “Për shkak të rrezikshmërisë së paketë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë

*kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale. Gjykata urdhëron që i dënuari të përmbushë një apo më shumë detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi.*

*Per denimet e dhena deri në dy vjet burgim, te pezulluara nga gjykata, afati i proves eshte sa dyfishi i kohes se denimit me burgim te dhene nga gjykata.*

*Afati i proves me perjashtim te rregullit te parashikuar në paragrafin 3 te ketij neni, eshte 24 muaj deri në 5 vjet. Afati i proves fillon nga e nesermja e shpalljes se vendimit te gjykates qe ka dhene vendim per pezullimin e denimit me burgim. Afati i proves mund te shkurtohet ose zgjatet në varesi te menyres se ekzekutimit te proves dhe kushteve personale te denuarit, por pa cenuar afatin minimal dhe maksimal te parashikuar në kete paragraf.*

*Nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60, siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit."*

*Nga interpretimi i nenit 59 rezulton se, ky nen i jep të drejtën gjykatës që, në raste të veçanta, kur jep dënimin me burgim gjer në pesë vjet të urdhërojë që i dënuari të vihet në provë duke u pezulluar ekzekutimi i dënimit. Gjithmonë, gjykata kur vendos është e detyruar të respektojë kriteret e përcaktuara në këtë nen. Kjo formë alternative e vuajtjes së dënimit me burgim, aplikohet nga gjykata kur plotësohen njëkohësisht dy kushte:*

*a) në përfundim të gjykimit gjykata çmon se i pandehuri duhet të dënohet jo më shumë së pesë vjet me burgim.*

*b) kur gjatë shqyrtimit rezulton se ekziston një nga rrethanat e mëposhtme, të cilat janë të pavarura nga njëra-tjetra por nuk përjashtojnë njëra-tjetrën: I pandehuri paraqet rrezikshmëri të pakët shoqërore; i pandehuri është i mitur apo i moshuar; i pandehuri ka kushte mendore apo shëndetësore të veçanta; i pandehuri ka detyrime për punën, arsimin, kualifikimin apo aftësimin profesional; i pandehuri ka përgjegjësi thelbësore për familjen; i pandehuri e ka kryer veprën në kushtet e disa rrethanave lehtësuese; i pandehuri ka pasur një sjellje shumë të mirë pas kryerjes së veprës penale.*

*Gjykata, në aplikimin e kësaj alternative të dënimit me burgim, duhet të mbajë parasysht edhe disa elementë të përgjithshëm, të cilat vlerësohen edhe në rastin e caktimit të dënimit dhe që lidhen me tipare të moshës dhe personalitetit të të dënuarit, rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe të autorit të saj, shkallën e fajit, rrethanat lehtësuese dhe rënduese, si elementë të përgjithshëm që lidhen me rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe sjelljen e autorit pas kryerjes së saj.*

*Në lidhje me zbatimin e alternativave të dënimit me burgim, Gjykata çmon t'i referohet qëndrimit të mbajtur në Vendimin e Nr.28 datë 26.01.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit: "...Sipas standardeve ndërkombëtare përdorimi i burgimit si formë dënimi duhet kufizuar rreptësisht dhe të jetë një extrema ratio në raste të veçanta, atëherë kur nuk mund të zbatohen masa të tjera të përshtatshme. Siç shprehet nga Këshilli i Evropës, burgimi duhet të zbatohet si masë vetëm "kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të papërshtatshme për rëndësinë e veprës", dhe duhen bërë përpjekje që të minimizohet përdorimi i masave që e privojnë personin nga liria dhe të zbatohen më shumë të cilat nuk e bëjnë këtë."*

*Në vlerësim të rrethanave të parashikuara nga neni 59 i Kodit Penal, si dhe duke vlerësuar qëllimin për të cilin legjislatori ka parashikuar alternativat e dënimit me burgim,*



Gjykata vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë kushtet ligjore dhe faktikë, që ndaj të pandehurit **Besri Kollari** aplikohet alternativa e “*Pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim*”, duke e vënë atë në provë për një periudhë prej 16 (gjashtëmbëdhjete) muajsh. Kështu, në respektim të kushtit të parë të parashikuar nga neni 59 i K.Penal, ndaj të pandehurit, Gjykata caktoi një masë dënimi me burgim jo më shumë se 5 vjet, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin **Besri Kollari** me 8 (tetë) muaj burgim.

Për sa i përket ekzistencës së rrethanave të tjera të parashikuara nga neni 59 i K.Penal, Gjykata evidenton faktin se nisur nga rrezikshmeria e paket e vepres penale, fakti që nuk është i dënuar me pare, si dhe fakti që ai nuk paraqet rrezikshmeri shoqerore Gjykata e Lartë, në lidhje me aplikimin e alternativave të dënimit, në Vendimin nr. 285, datë 06.11.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka theksuar se: “*Për të aplikuar në mënyrë sa më të drejtë nenin 59 të Kodit Penal, gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor ka për detyrë të identifikojë rrethanën e posaçme që ekziston në jetën e përditshme të të pandehurit.*”

Po ashtu, gjatë gjykimit rezultoi se vepra penale është kryer në kushtet e disa rrethanave lehtësuese. Alternativat e vuajtjes së dënimit me burgim, u drejtohen autorëve të veprave penale që shkelin për herë të parë ligjin, të cilët nuk paraqesin rrezikshmëri të lartë shoqerore dhe kur vepra penale në ngarkim të tyre nuk është shumë e rëndë.

Si përfundim, gjykata çmon se, aplikimi i dënimit alternativ në rastin konkret është plotësisht i justifikueshëm, duke e vendosur të pandehurin **Besri Kollari** në provë për një periudhë prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale. Gjykata vlerëson të theksojë se, kur aplikohet dënimi alternativ i parashikuar nga neni 59 i K.Penal, gjykata urdhëron që i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe në aplikim të nenit 60/9 të K.Penal i pandehuri detyrohet që gjatë periudhës së provës të mos shoqërohet me persona të dënuar.

Ky dënim, sipas Gjykatës është plotësisht i justifikueshëm, duke e krahasuar atë me rrezikshmërinë shoqerore të veprës penale të “*Pershtjajta e lokalit për përdorim droge*”, rrethanave të kryerjes së saj dhe rrezikshmërinë shoqerore të të pandehurit në rastin konkret.

Gjithashtu gjykata çmon se, ky dënim do t’i shërbejë edukimit të të pandehurit, parandalimit të kryerjes së veprave të tjera penale nga i pandehuri, rehabilitimit të tij, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri.

Duke qenë se i pandehuri **Besri Kollari** u deklarua fajtor dhe u dënua për veprën penale për të cilën akuzohen, bazuar në nenet 393 e 485 të K.Pr.Penale, i pandehuri detyrohet të paguajë shpenzimet proceduriale të kryera në fazën e hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore.

Sa u tha me sipër u provua me spjegimet e paleve dhe provat shkresore të administruara në dosje.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata bazuar në nenet 375, 379, 384, 390, 406 dhe 485 të K.Pr.Penale,

### **VENDOSI**

- Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurit **Besri Ramazan Kollari** për veprën

penale “*Prodhim dhe shitja e narkotikëve*” parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit **Besri Ramazan Kollari** për kryerjen e veprës penale të “*Përshjtatja e lokalit për përdorim droge*”, e parashikuar nga neni 285/a i K.Penal dhe në bazë të këtij neni, dënimin e të pandehurit me **1 (një) vit burgim**.

- Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri **Besri Ramazan Kollari** dënohet me **8 (tetë) muaj burgim**.

- Në aplikim të nenit 59 të K.Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vënë të pandehurin **Besri Ramazan Kollari** në provë, për një periudhë kohore prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajsh me kusht që, gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë asnjë vepër tjetër penale si dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës Tiranë.

- Në aplikim të nenit 60/9 të K.Penal i pandehuri detyrohet që gjatë periudhës së provës të mos shoqërohet me persona të dënuar.

- Afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

- Shuarjen e masës së sigurimit “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”, parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale nr.96 datë 19.01.2021 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kjo referuar nenit 261/1 pika “b” të K.Pr.Penale.

- Ngarkohet prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë për ekzekutimin e këtij vendimi.

- Shpenzimet procedurale në fazën e hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të pandehurit.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

*U shpall në Tiranë, sot më dt.21.07.2021 .*

**SEKRETARE  
GJYQTARI**

**-KATERINA**

**LLAKA-**

**-BEDRI QORI-**

<b>Shpenzime gjyqësore</b>			
	Sasia	Vlera	Totali/ lekë
Masa e sigurimit			3.000
Shpenzimet e prokurorisë			2.000
<b>Shpenzime gjyqësore</b>			
Avokat kryesisht			5000
njoftime	2	150	300
Shpenzime kancelarie			2.000

